



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANES

**SSH.07 STANDARDET E ADMINISTRATES DHE FINANCES**

### **SSH.07.01 Standardi i bazes ligjore te veprimtarise financiare**

Baza ligjore e veprimtarisë financiare të UPT duhet te jete:

- a) Ligji Nr. 9741, date 21.5.2007 “Për Arsimin e larte në Republikën e Shqiperise“ dhe aktet nënligjore nëzbatim të tij të nxjerra nga MASH dhe Ministria e Financave.
- b) Ligji Nr. 9720, date 23.4.2007 “Për auditin e brendshëm në sektorin publik” dhe aktet nënligjore në zbatim të tij të nxjerra nga MASH dhe Ministria e Financave.
- c) Statuti i UPT.
- d) Rregullore e Brendshme e UPT për Administrimin, Financimin dhe Kontabilitetin.
- e) Rregulloren e Brendshme e Këshillit të Administrimit të UPT.

Perdorimi i te ardhurave financiare ne UPT duhet te kryhet ne kete menyre:

1. Te ardhurat financiare që vijnë nga transfertat e pakushtëzuara të buxhetit të Shtetit duhet te përdoren në përputhje me rregullat e standardet e programimit buxhetor dhe menaxhimit financiar publik.
2. Të ardhurat e krijuara nga UPT duhet te përdoren tërësisht prej tij dhe pjesa e papërdorur e tyre duhet te mbartet në vitin pasardhës. Shpenzimi i të ardhurave të krijuara duhet te behet në përputhje me procedurat e buxhetit afatmesëm.
3. Në përdorimin e burimeve financiare përparësi duhet te kenë të ardhurat e veta.
4. Të gjitha transaksionet financiare në UPT duhet te kryhen nëpërmjet sistemit të thesarit.
5. UPT duhet te publikoje cdo vit raportin e vet për veprimtarinë financiare të universitetit dhe ta vere atë në dispozicion të publikut, Ministrisë së Financave dhe MASH.

### **SSH.07.02 Standardi i tarifave te studimeve**

1. Fakultetet e UPT duhet t'i propozojnë Rektoratit cdo vit masën e tarifës së rregjistrimit, kurse UPT duhet t'i propozon MASH masën e unifikuar të kësaj tarife.
2. Fakultetet UPT duhet t'i propozojnë Rektoratit çdo vit masen e tarifës të shkollimit për sistemin e studimeve në distancë. Tarifat e propozuara në çdo rast nuk mund të kalojnë vlerën e kostos së studimeve. UPT duhet te përcjelle propozimet e tyre në MASH.
3. Studentët e shkëlqyer nuk duhet te paguajnë tarifën e shkollimit në vitin akademik pasardhës, ne perputhje me aktet ligjore e nenlogjore.
4. E ardhura e UPT që realizohet nga tarifa e shkollimit për ciklin e parë dhe ciklin e dytë të studimeve duhet te ndahet ndërmjet njësite kryesore të UPT, në përputhje me aktet ligjore dhe nenligjore.

### **SSH.07.03 Standardi i kontrollit dhe auditit te brendshëm në UPT**

Kontrolli dhe auditimi i brendeshem ne UPT duhet te realizohet nga njesia e Auditit te brendeshem. Fusha e veprimt të kësaj njësie dhe funksionimi i saj duhet te bëhet në përputhje me kërkesat e ligjit Nr. 9720, date 23.4.2007 “Për auditin e brendshëm në sektorin publik” dhe të akteve nënligjore në zbatim të tij  
Njesia e Auditit te brendeshem varet nga Rektori  
Rezultatet e kontrollit dhe auditit behen publike.

### **SSH.07.04 Standardi i rregullave te administrimit dhe te raportimit financiar**

Rregullat e përgjithshme të administrimit dhe raportimit financiar të UPT duhet te jene të njëjta me ato të çdo institucioni tjetër publik.  
Rregulla të vecanta dhe specifike për administrimin dhe raportimin financiar duhet te vendosen në Rregulloren e Brendshme të UPT për Administrimin, Financimin dhe Kontabilitetin.

### **SSH.07.05 Standardi i dokumentimit te shërbimeve dhe pronave të UPT**

Rektorati dhe njësitë kryesore të UPT duhet:

- a) te publikojne listën e të gjitha shërbimeve standarde që kryejnë, me tarifat përkatëse të shërbimit si dhe gjithë shërbimet dhe ekspertizat e tjera që mund të kryejnë;
- b) të inventarizojnë, marketizojnë dhe dokumentojnë të gjitha pronat e paluajtshme që ka në përdorim si dhe aktivet e mundshme për dhënie në përdorim për palët e treta.

Kopje të dokumentacionit të mësipërm duhet te vihen ne dispozicion te Rektoratit.

### **SSH.07.06 Standardi i fondit te promovimit**

Ne buxhetin e UPT duhet te parashikohet fondi i promovimit.

Ky fond duhet te përdoret për të promovuar produktet e UPT.

Masa e këtij fondi duhet te miratohet nga Këshilli i Administrimit dhe mënyra e përdorimit duhet te përcaktohet në Rregulloren e Brendshme për Administrimin, Financimin dhe Kontabilitetin.

### **SSH.07.07 Standardi i transfertes me konkurim për investime**

Transferta me konkurim per investime duhet te perdoret per:

- a) financimin e investimeve me karakter ndertimi;
- b) per projekte te tjera te medha sipas klasifikimit ne procedurat per manaxhimin e investimeve publike;
- c) per projekte te kerkimit shkencor.

UPT duhet t'u garantoje njësite kryesore të tij mundësi të barabarta për të përfituar nga financimet e Buxhetit të Shtetit nëpërmjet transfertave me konkurim, sipas pikave 1 dhe 2 te ketij neni. Rektorati i UPT duhet te bëje sugjerimet e tij dhe te inkurajoje pjesëmarrjen në to te njësite përbërse të UPT.

UPT duhet t'u garanton punonjësve akademikë të tij mundësi të barabarta për të përfituar nga financimet e Buxhetit të Shtetit nëpërmjet transfertave me konkurim.

Ne cdo rast aplikanteve duhet t'u garantohet minimalisht 2 muaj kohë, nga data e shpalljes se ofertave, për t'u njohur me ofertat, për të përgatitur dhe paraqitur projektet.

### **SSH.07.08 Standardi i financimeve jashte buxhetit te shtetit**

UPT dhe njësitë përbërse të tij konkurojnë me programe dhe projekte specifike në projekte të nxitura nga administrata shtetërore, nga entet jopublike ose private si dhe nga institucionet ndërkombëtare. Për të nxitur dhe inkurajuar pjesëmarrjen në këto projekte hartuesit e projekteve shpërblehen në perputhje me aktet ligjore e nenligjore ne fuqi.

### **SSH.07.09 Standardi i çmimeve akademike për studentë**

Për të nxitur veprimtarinë mësimore dhe shkencore të studentëve, krijimin e shembujve, praktikave dhe modeleve të punës së mirë, Rektorati në bashkëpunim me Këshillat e Fakulteteve, duhet te krijojne çmime akademike specifike për studentë, me emërtime dhe shperblime përkatëse.

Masa e shpërblimit për çdo çmim duhet te miratohet nga Këshilli i Administrimit. Dhënia e çmimeve duhet te bëhet me ceromoni vjetore në shkallë universiteti dhe dorëzimi i tyre duhet te behet nga Rektori, në prani të përfaqësuesve të Senatit, të profesoratit, administratës dhe studentëve.